

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6219
E enjte, 21 janar 2021
çmimi 0.40

Qeveria në detyrë
do të ndajë paga shtesë
edhe për arsimtarët



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

JOE BIDENI KA BËRË BETIMIN E PRESIDENTIT
TË 46 TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) | FAQE 2



BETOHET PRESIDENTI BIDEN

Demokrati Joe Biden ka bërë betimin e presidentit të 46 të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). "Betohem solemnisht se do ta përmbush me besnikëri detyrën time të presidentit të Shteteve të

Bashkuara dhe se do ta ruaj dhe ta mbroj më së miri Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara", ka thënë Bideni teksa është betuar para gjykatësit të Gjykatës Supreme, John Roberts. Në fjalimin e tij të parë para

Kongresit Amerikan, presidenti Biden përçoi mesazhe uniteti dhe vlerësoi demokracinë amerikane. "Do të jem president i të gjithë amerikanëve", ka thënë presidenti Biden

OPINION

A DO TA TUNDË NARD NDOKA
FLAMURIN E OPOZITËS?! F. 12

Bedri
ISLAMI



AKTUALE

POLICIA E KOSOVËS
MBAN TAKIM ME PARTNERËT
STRATEGJIKË TË SAJ F. 7

HOXHAJ PREMTON SE
VETERANËVE DO T'U RRIET
PENSIONI PËR 30 PËR QIND F. 6



EKONOMI

MAZREKU DHE AHMETI
NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM
BASHKËPUNIMI F. 8

RUKIQI: SHBA-ja, PARTNERE
E FUQISHME PËR SEKTORIN
PRIVAT NË KOSOVË F. 8



SPORT

DUMOSHI: MKRS-ja VAZHDIMISHT
I PËRKRAH SPORTISTËT E RINJ F. 12

KOK-u I PËRZGJODHI
10 BURSISTËT E RINJ F. 12

ALBIN KURTIT DHE 46 KANDIDATËVE U NDALOHET TË GAROJNË NË ZGJEDHJE

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka konstatuar se 47 kandidatë për deputetë për zgjedhjet e 14 shkurtit nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. KGJK-ja dhe as KQZ-ja nuk kanë treguar emrat e kandidatëve, por burimet e gazetës kanë treguar se bëhet fjalë për liderin e

LV-së, Albin Kurti dhe katër kandidatë të tjerë të kësaj partie. I njëjti burim ka thënë se ndalohen të kandidojnë në zgjedhje edhe një kandidat i LDK-së, një i PDK-së, tre të AAK-së dhe 12 kandidatë të Nismës. Këta kandidatë kanë të drejtë ankese në PZAP dhe Gjykatë Supreme



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
Ndërtim
Projektim
shitje
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin", Kosov",
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Joe Biden ka bërë betimin e presidentit të 46 të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA)

Betohet presidenti Biden



Demokrati Joe Biden ka bërë betimin e presidentit të 46 të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). “Betohehem solemnisht se do ta përmbush me besnikëri detyrën time të presidentit të Shteteve të Bashkuara dhe se do ta ruaj dhe ta mbroj më së miri Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara”, ka thënë Bideni teksa është betuar para gjykatësit të Gjykatës Supreme, John Roberts. Në fjalimin e tij të parë para Kongresit Amerikan, presidenti Biden përçoi mesazhe uniteti dhe vlerësoi demokracinë amerikane. “Do të jem president i të gjithë amerikanëve”, ka thënë presidenti Biden

“Epoka e re”

NJU-JORK, 20 JANAR - Presidenti i ri, i 46-ti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, sot është betuar. “Betohehem solemnisht se do ta përmbush me besnikëri detyrën time të presidentit të Shteteve të Bashkuara dhe do ta ruaj dhe ta mbroj më së miri Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara. Me ndihmo, Zot!”, ka thënë Bideni teksa është betuar para gjykatësit të Gjykatës Supreme, John Roberts. Edhe zëvendëspresidentja e Shteteve të Bashkuara, Kamala Harris, ka bërë betimin në

pozitën e re.

Bideni ka pohuar se kjo është dita e Amerikës. “Kjo është dita e demokracisë. Një ditë e historisë dhe shpresës”, tha presidenti i Shteteve të

BE-ja bën thirrje për një fillim të ri të raporteve me ShBA-në

Bashkimi Evropian ka bërë thirrje për një fillim të ri të raporteve me ShBA-në. Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, foli për nevojën e një “pakti të ri” për marrëdhëniet transatlantike. Ai e ftoi presidentin e zgjedhur amerikan Joe Biden për një samit ShBA-BE në Bruksel.

“Sot është mundësia e rinovimit të raporteve transatlantike të cilat kanë pësuar gjatë katër vjetëve. Më shumë se kurrë më parë kjo kërkon që evropianët ta marrin përsipër fatin e tyre për t’i mbrojtur interesat dhe vlerat tona. Së bashku me ShBA-në duhet të qëndrojmë si një

shtyllë e fortë për mbrojtjen e rendit botëror të bazuar në ligje, duke punuar për paqe, siguri, prosperitet, liri, të drejta të njeriut dhe barazi gjinore”, ka thënë Michel. Komentet e tij janë bërë gjatë një debati të organizuar në seancën plenare të Parlamentit Evropian.

Bashkuara, Joe Biden, pasi bëri betimin në platformën e Kongresit Amerikan. “Amerika është provuar dhe është ngritur ndaj sfidave. Sot ne festojmë jo fitoren e një kandidati, por të një kauze, një kauze të demokracisë. Ne

mësuam përsëri se demokracia është e çmuar. Demokracia është e brishtë dhe, në këtë moment, miqtë e mi, demokracia ka mbizotëruar”, ka thënë Biden, duke u zotuar se do të jetë president i të gjithë amerikanëve. Bideni u inaugurua dy javë pasi mbështetës të presidentit të deritashëm, Donald Trump, sulmuan ndërtesën e Kongresit Amerikan, në përpjekje për ta përmbysur rezultatin e zgjedhjeve. Biden, 78 vjeç, është presidenti më i vjetër amerikan që merr detyrën. Ai i ka fituar zgjedhjet presidenciale të 3 nëntorit 2020 kundrejt presidentit të deritanishëm, Donald Trump. Kongresi e ka miratuar fitoren e

tij më 6 janar.

Inaugurimi është një ceremoni zyrtare që shënon fillimin e një presidenciale të re në Shtetet e Bashkuara dhe, sipas ligjit, zhvillohet më 20 janar në Uashington.

Ceremonia e inaugurimit sivjet është ndër më të pazakonshmet në historinë e Shteteve të Bashkuara. Ajo zhvillohet nën masa të pashembullta të sigurisë të cilat pasojnë dhunën e 6 janarit në ndërtesën e Kongresit. Ish-presidenti Donald Trump nuk mori pjesë në ceremoni, por aty ishte ish-nënpresidenti Mike Pence. Pjesëmarrja e publikut në inaugurim ishte, po ashtu, rreptësisht e kufizuar për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Trumpi largohet nga Shtëpia e Bardhë

Donald Trump dhe gruaja e tij Melania janë larguar të mërkurën nga Shtëpia e Bardhë. Ai përmes helikopterit Marine One shkoi drejt bazës ushtarake Joint Base Andrews, në Merillend, ku mbajti një fjalim të shkurtër. “Kanë qenë katër vjet të pabesueshëm. Kemi arritur aq shumë së bashku”, tha presidenti në largim i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump. “Ajo që kemi bërë, ka qenë e mahnitshme me të gjitha standardet”, ka thënë Trump, duke përmendur ndryshimet në ushtrinë amerikane, krijimin e vaksinës kundër koronavirusit e të tjera.

Edhe 166 specializantë të rinj do ta nisin shkollimin specialistik

PRISHTINË, 20 JANAR (ER) - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se edhe 166 specializantë të rinj do ta nisin shkollimin specialistik. Ai ka thënë se ky është një lajm i mirë për shëndetësinë dhe shtetin tonë. "Këta specializantë do

t'i nisin specializimet më 1 shkurt dhe janë me financim të Ministrisë së Shëndetësisë. Sot, po ashtu, prita një grup të specializantëve të cilët kanë nënshkruar kontratat për ta vazhduar specializimin. Entuziazmi dhe pasioni i tyre për ta vazhduar specializimin është

për t'u vlerësuar shumë. Nga marrja e mandatit e zbatova zotimin tim se asnjë mjek nuk do të jetë pa punë në Kosovë. I pranuar të gjithë aplikantët për specializim dhe konkursi për specializimet do të vazhdojë edhe këtë vit", ka thënë Zemaj të mërkurën.



Mbi 1 400 të vdekur nga Covidi në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka njoftuar se të mërkurën janë shënuar edhe gjashtë viktime nga Covid-19. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Deçan, Fushë-Kosovë, Mitrovicë, Obiliq, Podujevë, Vushtrri. Në raportin ditor të situatës epidemiologjike, IKShPK-ja thotë se, bazuar në 1 683 mostra të testuara, 320 kanë dalë pozitive me Covid

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 JANAR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 683 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 320 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar gjashtë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Deçan një rast (80 vjeç), Fushë-Kosovë një rast (70 vjeç), Mitrovicë një rast (76 vjeç), Obiliq një rast (55 vjeç), Podujevë një rast (56 vjeç), Vushtrri një rast (72 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 56 732 raste nga 213 372 persona të dyshimtë me këtë virusi dhe 1 426 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 269 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është



gjithsej 49 982 raste, kurse numri i rasteve aktive është 5 324.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 115 raste,

Vushtrri 21 raste, Prizren 19 raste, Lipjan 17 raste, Podujevë 17 raste, Fushë-Kosovë 13 raste, Gjakovë 13 raste, Gjilan 11 raste, Malishevë 11 raste, Pejë 11

raste, Shtime 10 raste, Ferizaj 9 raste, Klinë 8 raste, Suharekë 7 raste, Mitrovicë 6 raste, Drenas 5 raste, Graçanicë 4 raste, Kaçanik 4 raste, Kamenicë 3

raste, Obiliq 3 raste, Skenderaj 3 raste, Deçan 2 raste, Junik 2 raste, Viti 2 raste, Rahovec 2 raste dhe me nga një rast komunat Istog dhe Mamushë.

Mustafa uron Armin Laschet për zgjedhjen në krye të CDU-së

PRISHTINË, 20 JANAR (ER) - Me rastin e zgjedhjes së presidentit të ri të CDU-së, Armin Laschet, kryetari i Lidhjes demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, i ka dërguar atij telegram urimi. "Lidhja Demokratike e Kosovës paraqet komplimentet për të gjitha parimet e Unionit Demokristian (CDU) dhe ju dërgon urimet e përzemërta për zgjedhjen tuaj presidenti i CDU-së. Unë ju dërgoj të gjitha urimet më të mira për ushtrimin e mandatit tuaj të ri dhe jam i lumtur t'ju informoj se partia jonë dhe populli i Kosovës me shumë kënaqësi e

kanë pritur këtë lajm. Deri sa ju filloni me përgjegjësitë tuaja të reja, dëshiroj t'ju siguroj ju dhe CDU-në për miqësinë dhe bashkëpunimin tonë të vazhdueshëm në interes të partive tona dhe prosperitetet për popullin tonë", ka thënë Mustafa.

Ai ka shtuar se LDK-ja tashmë po punon ngushtë me CDU-në në kuadër të Partive Popullore Evropiane. "Bashkëpunim i cili uroj të vazhdojë edhe gjatë mandatit tuaj. I dashur z. Laschet, më lejoni ta marr lirinë që ta shpreh mirënjohjen tonë për kancelaren Merkel për



mbështetjen e saj të vazhdueshme për vendin dhe partinë tonë. LDK-ja dhe populli i Kosovës i janë përgjithmonë mirënjohës për mbështetjen e saj të palëkundur për Kosovën, për pavarësinë dhe vendin tonë në Bashkimin Evropian. Shkëlqesia juaj, pres të takohem me ju gjatë samiteve tona të radhës të EPP-së dhe të shfrytëzoj këtë mundësi ta ripërsërisë vlerësimin tonë të lartë ndaj partisë demokristiane", ka thënë kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, në këtë urim.



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS I KA KTHYER PËRGJIGJE KQZ-SË
PËR VERIFIKIMIN E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË

Albin Kurtit dhe 46 kandidatëve u ndalohet të garojnë në zgjedhje

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka konstatuar se 47 kandidatë për deputetë për zgjedhjet e 14 shkurtit nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. KGjK-ja dhe as KQZ-ja nuk kanë treguar emrat e kandidatëve, por burimet e gazetës kanë treguar se bëhet fjalë për liderin e LV-së, Albin Kurti dhe katër kandidatë të tjerë të kësaj partie. I njëjti burim ka thënë se u ndalohet të kandidojnë në zgjedhje edhe një kandidat i LDK-së, një i PDK-së, tre të AAK-së dhe 12 kandidatë të Nismës. Këta kandidatë kanë të drejtë ankese në PZAP dhe Gjykatë Supreme

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 JANAR - Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka bërë verifikimin e kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e 14 shkurtit, duke ia kthyer listën KQZ-së. Kjo e fundit ka njoftuar se Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka konstatuar që 47 kandidatë për deputetë që kanë aplikuar për regjistrim nuk mund të certifikohen sepse kanë vendime gjyqësore të formës së prerë në tre vjetët e fundit. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar se nga 28 subjekte politike që kanë

aplikuar për certifikim për zgjedhjet e parakohshme, 15 prej tyre kanë kandidatë të cilët nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. "Nga përgjigjja që kemi marrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, rezultojnë se 15 nga 28 subjektet politike që kanë aplikuar për certifikim kanë kandidatë të cilët nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, germën q, e cila specifikon se kandidat për deputet nuk mund të jetë një person i cili është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të

gjykatës në tre vjetët e fundit. Në përgjithësi, janë 47 kandidatë nga rreth 1 080 të cilët janë shpallur fajtorë për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tre vjetët e fundit", ka thënë Elezi. Megjithatë, ai nuk i ka dhënë emrat e këtyre kandidatëve dhe as të subjekteve politike të cilave ata u takojnë. Mirëpo gazeta "Epoka e re" nga burimet e saj ka mësuar se bëhet fjalë për liderin e LV-së, Albin Kurti dhe katër kandidatë të tjerë të LV-së. I njëjti burim ka thënë se u ndalohet të kandidojnë në zgjedhje edhe një kandidati të LDK-së, një të PDK-së, tre të

AAK-së dhe 12 kandidatëve të Nismës.

Elezi ka sqaruar se Zyra për Regjistrim e Partive Politike dhe Certifikim do të përgatitë rekomandimin për aprovimin apo refuzimin e certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. "Pas pranimit të këtyre përgjigjeve, Zyra për Regjistrim e Partive Politike dhe Certifikim do të përgatitë rekomandimin për aprovimin apo refuzimin e certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. Këto rekomandime do të paraqiten në mbledhje të KQZ-së. Sipas Planit Operacional të miratuar nga KQZ-ja, rekomandimet do të bëhen gati gjatë ditës së sotme dhe të nesërme, ndërsa KQZ-ja do të marrë vendim më së largu deri më 22 janar", ka deklaruar ai, duke shtuar se partitë politike do të njoftohen për vendimet në mënyrë që t'i plotësojnë listat e tyre. "Gjithashtu, do të njoftohen subjektet politike, secila prej tyre, për përgjigjet që kemi pranuar nga institucionet, në mënyrë që të mund ta bëjnë plotësimin e

listës me kandidatë të tjerë, në rast se ndonjë kandidat nuk i ka plotësuar kriteret ligjore", është shprehur ai.

Zëdhënësi i KQZ-së ka bërë me dije se të gjitha partitë që nuk janë të kënaqura me këtë vendim kanë të drejtë të ankohen në PZAP dhe Gjykatën Supreme. "Në rast se ndonjë subjekt politik apo kandidat nuk certifikohet, ai mund të paraqesë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Çështja mund të shkojë deri në Gjykatën Supreme nëse pala mund të jetë e pakënaqur me vendimin e PZAP-it", ka thënë ai, duke treguar se perioda e ankesës dhe e vendosjes është paraparë të përmbyllet deri më 31 janar.

Ditë më parë KQZ-ja ka kërkuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, konfirmimin për përshtatshmërinë e kandidatëve për deputetë, bazuar në nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

GLPS-ja kundërshton përfshirjen në lista zgjedhore të kandidatëve me aktakuza dhe dënime

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka analizuar të gjitha listat e kandidatëve për deputetë të shpallura nga partitë politike për zgjedhjet e jashtëzakonshme që do të mbahen më 14 shkurt, duke identifikuar kështu një numër kandidatësh të cilët janë nën procedura gjyqësore apo edhe kanë dënime të formës së prerë për vepra penale. Në lidhje me këtë, GLPS-ja ka shprehur shqetësimin dhe kundërshton çdo përfshirje në listë të kandidatëve për deputetë të personave me aktakuza dhe dënime për vepra penale të korrupsionit, keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe vepra të tjera të

ndërlidhura që dëmtojnë rëndë besueshmërinë e Kuvendit dhe vendimeve që merren. "Pavarësisht prezumimit të pafajësisë (për ato raste me aktakuza aktive), GLPS-ja kërkon që përbërja e re e Kuvendit duhet medoemos që të formojë një grup punues i cili ka qëllim, bazuar në standarde objektive dhe parime të qarta të vendeve demokratike, t'i propozojë ndryshimet e nevojshme ligjore (pa përjashtuar edhe ato kushtetuese) që sqarojnë rrethanat ku e drejta për t'u zgjedhur në Kuvendin e Kosovës mund të kufizohet. Për dallim nga aktgjykimi dhe qasja arbitrare e Gjykatës

Kushtetuese, përbërja e re e Kuvendit duhet ta gjejë konsensusin për të ndërtuar kufizime mbi kandidatët për deputetë mbi baza të qarta kushtetuese, sidomos duke marrë parasysh vendet demokratike, ku një gjë e tillë parashikohet për individët që janë dënuar për vepra të rënda penale, me vendime me burg efektiv, dhe të cilat për nga natyra përfshijnë elemente të qarta të qëllimit dhe dashjes, sidomos ato që lidhen me korrupsionin, tradhtinë kombëtare, keqpërdorimin e detyrës zyrtare, krimin e organizuar, vjedhjen, vrasjen e të ngjashme", është thënë në reagimin e GLPS-së.

Haxhiu: Qytetarët të shqetësuar për heqjen e Kurtit nga lista e deputetëve




Kandidatja e LV-së për deputete, Albulena Haxhiu, e ka konfirmuar se lideri i kësaj partie, Albin Kuti, nuk është certifikuar nga KQZ-ja për të qenë kandidat për deputet në

zgjedhjet e 14 shkurtit. Në llogarinë e vet në "Facebook", ajo ka shkruar se qytetarët me të drejtë janë të shqetësuar për tendencat e qëllimshme për largimin nga lista të Albin Kurti.

"Albini gëzon mbështetje shumë të madhe qytetare dhe kjo mbështetje është e pakontestuar, prandaj qytetarët me të drejtë janë të shqetësuar për tendencat e qëllimshme për largimin nga

lista të Albinit. Në shtetin e kapur, kështu ndodh! Këto janë përpjekjet dhe shkelmat e fundit të atyre që e kapën shtetin dhe të atyre që i shërbyen shtetit të kapur!", ka shkruar Haxhiu.



Haradinaj: Si president do të jem roje i Kosovës

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 JANAR - Kandidati për president të Kosovës nga Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, i ka bërë thirrje spektrit politik në vend për bashkim në mënyrë që të jetë më e lehtë përballja me sfidat që e presin Kosovën dhe pasojat që ka shkaktuar pandemia. Haradinaj përmes një video-incizimi ka thënë se ëndrrat tona mund t'i realizojmë vetëm duke qenë së bashku. "Në këtë vit ne jo vetëm se duhet të përballemi me pasojat e pandemisë, me rikthimin dhe ringjalljen ekonomike të vendit, por ne duhet të punojmë që ta forcojmë Kosovën në planin e sigurisë, që t'i përmirësojmë arsimin, shëndetësinë, sundimin e ligjit. Ne, pra forcat politike, duhet të jemi të bashkuar për t'u përballur me të gjitha këto pasoja, e me gjitha

këto sfida që e presin Kosovën. E di se e kemi ëndërr të gjithë ne që Kosova jo vetëm që të forcojë ushtrinë e sigurinë e vendit, por edhe të anëtarësohemi në NATO. Do ta realizojmë ëndërrën tonë së bashku. E kemi po ashtu ëndërr t'i bashkohemi familjes evropiane, të jemi anëtar i BE-së. Do të punojmë në këtë drejtim që Kosova të anëtarësohet në BE dhe OKB, pra na pret shumë punë. Jam i bindur që shumë prej nesh në Kosovë, e ndonjë rast edhe unë vetë, kam qenë i zhgënjyer me politikën në Kosovë", ka thënë Haradinaj.

Ai ka thënë se ka kërkuar besimin për president të vendit në mënyrë që vetëm kështu mund të jetë, siç shprehet ai, roje i Kosovës. "Unë e kam kërkuar besimin tuaj që të jem president i vendit, e nëse zgjidhem president, do të jem roje i Kosovës, i Kosovës së pavarur, i Kosovës që është shtëpia e të



gjithë neve, e që e arritëm me shumë mund, me shumë dhimbje, me shumë gjak, me shumë sakrificë. Kërkoj të jemi të bashkuar, pra për Kosovën

tonë", është shprehur Haradinaj.

Ai ka thënë se 14 shkurti e fuqizon Kosovën duke e cilësuar si nisje e re për

vendin. "Kërkoj që më 14 shkurt të gjithë ta fuqizojmë Kosovën. Le të jetë 14 shkurti një nisje e re për Kosovën", ka përfunduar Haradinaj.

Hoxhaj premtton se veteranëve do t'u rritet pensioni për 30 për qind

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

MITROVICË, 20 JANAR - Kandidati për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka premtuar rritje të pensioneve për veteranët për 30 për qind gjatë takimit që ka zhvilluar me veteranët, familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës në Mitrovicë. Me këtë rast, ai ka folur për mungesën e shokëve, themeluesve të UÇK-së, të PDK-së dhe shtetit të Kosovës, Kadri Veselit dhe Hashim Thaçit.

Ai është shprehur i bindur se ata do të kthehen fitimtarë nga Haga, derisa ka kërkuar



mbështetjen e bashkëluftëtarëve të tyre për zgjedhjet e 14 shkurtit. "Ne jemi të sigurt që të dy do të kthehen fitimtarë dhe faqebardhë. Ne

jemi të sigurt që të dy do ta mbrojnë kauzën e drejtë të luftës tuaj, të luftës sonë për liri. Prej neve si bashkudhëtarë të tyre, si shokë të tyre, si

bashkëpunëtorë të tyre, si bashkëpartiakë të tyre, kërkohet që ta bëjmë maksimumin në këto zgjedhje, që sa më e fortë që do të jetë PDK aq më e fortë do të jetë Kosova dhe po aq më të fortë do të jenë edhe shokët tanë në gjykatë", ka theksuar Hoxhaj.

Sipas tij, këto zgjedhje nuk janë zgjedhje si i kemi pasur zgjedhjet e kaluara, mbi të gjitha janë zgjedhje për dinjitetin, janë zgjedhje për dinjitetin edhe të UÇK-së, edhe të PDK-së, edhe të Kosovës. Hoxhaj para veteranëve ka shpalosur edhe planin e qeverisjes, ku prioritet ka zhvillimin ekonomik të vendit, shëndetësinë, arsimin si

dhe rritjen e pensioneve për veteranët për 30 për qind. "Prioritet mbi prioritetet e kemi pozitën tuaj. Bedriu ka biseduar gjatë me ekspertët më të mirë të ekonomisë. Ne do t'i rrisim pensionet e veteranëve deri në 30 për qind. Jemi shumë të vendosur që të ketë rritje të pensioneve të veteranëve deri në 30 për qind, që mos të ketë ndërprerje të pensioneve nëse dikush ka kontratë pune diku tjetër dhe që për familjet e dëshmorëve nëse një familje e ka një dëshmor ose dy dëshmorë, duhet të marrë jo vetëm një pension, por duhet të marrë sa dëshmorë ka", ka theksuar Hoxhaj në Mitrovicë.

Limaj merr mbështetje të madhe në Ferizaj për zgjedhjet e 14 shkurtit

FERIZAJ, 20 JANAR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka zhvilluar disa takime me bashkëluftëtarë, struktura e qytetarë të Ferizajt, qytet për të cilin ka thënë se është kthyer në promotor të projektit për mbrojtjen e vlerave kombëtare. Limaj gjatë qëndrimit në Ferizaj ka zhvilluar dy takime të mëdha, të cilat i ka cilësuar të ngrohëta me bashkëluftëtarë dhe struktura të Nismës Socialdemokrate, në Nerodimë dhe në nëndegën e parë në qendër të Ferizajt. "Është

pikërisht ky vullnet real e me zemër i bashkëluftëtarëve, të rinjve e njerëzve të ndershëm në Ferizaj dhe gjithë Kosovën, që po na jep forcë për betejën tonë për mbrojtjen e vlerave kombëtare, të cilën do ta çojmë deri në fund", ka shkruar Limaj në faqen e tij zyrtare në "Facebook".

Në fund, Limaj ka falënderuar mbështetësit e tij në Nerodimë dhe Ferizaj që po mbështesin kandidatët e kësaj partie për deputetë dhe që jeni rreshtuar krah vizionit e projektit të tij për zgjedhjet e 14 shkurtit.



Qeveria në detyrë do të ndajë paga shtesë edhe për arsimtarët

Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), të cilëve u ka siguruar se qeveria në detyrë do të ndajë paga shtesë edhe për punëtorët e arsimit. Këstin e parë do ta marrin me pagën e muajit shkurt, ndërsa këstin e dytë me pagën e muajit maj

pagën e muajit maj. Për shumën e pagës shtesë, Ministria e Arsimit, SBASHK-u dhe Ministria e Financave do të merren vesh në përputhje me mundësitë buxhetore. Në takim me përfaqësuesit e SBASHK-ut, kryeministri në detyrë, Hoti, ka biseduar edhe për Kontratën e re Kolektive e cila pritet të finalizohet këtë të premte. Në lidhje me këtë lajm ka reaguuar anëtarja e kryesisë e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie

Nagavci, e cila ka thënë LDK-ja asnjëherë nuk e ka pasur prioritet arsimin. "Madje kanë një përgjegjësi të madhe për gjendjen në të cilën ky sektor është. Dhe ajo që është më e rëndësishme, nuk mund t'i mashtroni e manipuloni mësimdhënësit, se ata nuk shiten. Punëtorët e arsimit janë të vetëdijshëm se me fraza të kota, premtime që s'i mbani, e manipulime e shfrytëzim në kohë fushate, nuk mund të përparojnë as individualisht e as

kolektivisht", ka shkruar Nagavci në llogarinë e vet në "Facebook". Ajo ka theksuar se është koha e fundit kur duhet që arsimi të jetë prioritet me buxhet, me planifikim të mirëfilltë për t'i mbështetur mësimdhënësit për krijimin e kushteve për punë, për të garantuar siguri në shkollë, për ta rritur bashkëpunimin dhe gjithëpërfshirjen. "Jo me premtime të kushtëzuara, por me dinjitet", ka pohuar Nagavci.

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 JANAR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), të cilët i ka siguruar se qeveria në detyrë do të ndajë paga shtesë edhe për punëtorët e arsimit. Kryeministri Hoti fillimisht e ka përgëzuar kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, për punën e palodhshme dhe sfiduese të arsimtarëve në kushte të pandemisë, si dhe e ka siguruar që pagesa shtesë për punëtorët e arsimit do të kryhet në dy këste. Këstin e parë do ta marrin me pagën e muajit shkurt, ndërsa këstin e dytë me



PDK-ja në Prizren reagon pas ftesës së Speciales për Nezir Çoçajn



PRIZREN, 20 JANAR (ER) - Dega e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK) në Prizren ka reaguuar pas lajmit se kandidati për deputet në zgjedhjet e 14 shkurtit, Nezir Çoçaj, është ftuar për intervistim nga Gjykata Speciale. "Si e gjithë UÇK-ja që është në shënjestër të orkestrimeve, këto ditë po sfidohet edhe PDK-ja, përkatësisht kandidati i kësaj partie për deputet në zgjedhjet e 14 shkurtit. Andaj, Partia Demokratike e Kosovës, Dega në Prizren, mbështet fuqimisht kandidatin e saj z. Nezir Çoçaj në këto ditë kur po tentohet që të njolloset figura e tij", është

thënë në komunikatën e Degës së PDK-së në Prizren. Sipas Degës së PDK-së në Prizren, Nezir Çoçaj në luftë ishte luftëtar i dalluar i UÇK-së, pas luftës u angazhua për forcimin e shtetit në institucionet e Republikës së Kosovës, duke e fituar dy herë besimin e popullit për deputet në Kuvendin e Kosovës. "Shpresojmë se edhe këtë herë do ta fitojë besimin e popullit për të qenë në vijën e parë për ta mbrojtur në mënyrë institucionale luftën e drejtë të UÇK-së dhe vlerat e luftës në përgjithësi. Nezir Çoçaj, duke qenë për shumë vite

udhëheqës i Institutit Pedagogjik të Kosovës, ka kontribuar shumë në fushën e arsimit, meqë edhe synimi i tij është për një arsimim të shëndoshë dhe gjithëpërfshirës. Ai ka ndihmuar shumë në jetësimin e kurikulës së re të arsimit, duke qenë pjesë aktive e hartimit të kësaj kurikule me standarde evropiane", është theksuar në këtë komunikatë, duke shtuar se sfidat për Çoçajn dhe për PDK-në nuk kanë qenë dhe nuk do të jenë asnjëherë pengesë për zbatimin e amanetit të dëshmorëve dhe heronjve të Kosovës.

Policia e Kosovës mban takim me partnerët strategjikë të saj

PRISHTINË, 20 JANAR (ER) - Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës është mbajtur të mërkurën një takim virtual me partnerët strategjikë të policisë. Ky takim u realizua me qëllim të koordinimit dhe mbështetjes së partnerëve në projekte të

identifikuara si dhe për përcaktimin e aktiviteteve me prioritet për Policinë e Kosovës. Me këtë rast, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka falënderuar miqtë dhe partnerët e policisë të cilët na kanë mbështetur përgjatë të

gjitha fazave të zhvillimit të organizatës së tyre. Ai ka thënë se Policia e Kosovës do ta vazhdojë bashkëpunimin me partnerët për ndërtimin e kapaciteteve dhe për ofrimin e shërbimeve policore në mënyrë të përgjegjshme, transparente dhe efikase.



Rukiqi: ShBA-ja, partnere e fuqishme për sektorin privat në Kosovë



Prishtinë, 20 janar (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, është takuar me John Jovanović, drejtues i Korporatës Zhvillimore Amerikane (DFC) për Evropën Juglindore. Me këtë rast, Rukiqi ka thënë se me Jovanovićin kanë biseduar për përfshirjen e

kësaj korporate amerikane për financimin e projekteve të sektorit privat në Kosovë. "Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të vazhdojnë të mbetën partnere i fuqishëm për sektorin privat në Kosovë. Sot në takim me John Jovanović, drejtues i Korporatës

Zhvillimore Amerikane (DFC) për Evropën Juglindore, vazhduam diskutimet për përfshirjen e kësaj korporate amerikane në financimin e projekteve të sektorit privat në Kosovë", ka shkruar Rukiqi në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se me fokus të veçantë në këtë takim u diskutua për sektorin e energjisë. "Në fokus të veçantë projektet në energji, projektet që mundësojnë integrimin në tregjet globale të furnizimit (nearshoring) dhe instrumentet e reja financiare për

përkrahje të bizneseve fillestare dhe të NVM-ve. Vazhdimësia e përkushtimit amerikan, për përkrahje të Kosovës, u konfirmua edhe nga sekretari i nominuar Blinken gjatë dëgjimeve për konfirmim në Senatën Amerikan", u shpreh Rukiqi.

Kërkohet nga KEDS-i që mos të ketë ndërprerje të energjisë elektrike ditën e votimit



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 JANAR - Ministri në detyrë i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj, ka takuar të mërkurën menaxhmentin e KEDS-it, me të cilin ka diskutuar për gjendjen me

furnizim të energjisë elektrike në vend.

Gjatë takimit Nitaj ka kërkuar nga menaxhmenti i KEDS-it që të ketë furnizim të mirë me energji elektrike në tërë territorin e Kosovës gjatë këtyre ditëve, kur temperaturat kanë rënë nën zero. Porosi e veçantë e Nitajt ishte që

të mos ketë ndërprerje të energjisë elektrike në asnjë qendër të votimit gjatë 14 shkurtit, kur në Kosovë mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare.

Menaxhmenti i KEDS-it e ka njoftuar ministrin Nitaj se situata më problematike mund të

paraqitet në Komunën e Malishevës si pasojë e problemeve të trashëguara më parë. Nitaj ka kërkuar nga KEDS-i që paraprakisht të sigurohen mundësi alternative të furnizimit me energji elektrike gjatë ditës së votimeve në të gjitha qendrat e votimit në këtë komunë.

KEDS-i u zotua që do të bëjë çdo gjë që është e mundur që furnizimi me energji elektrike të mos mungojë gjatë ditës së votimit, ndërsa njoftoi që ekipet do të dalin në terren për ta kontrolluar gjendjen e stabiliteteve teknike në objektet të cilat do të jenë si qendra votimi.

Sindikata e Punëtorëve e Aviacionit Civil reagon për ndryshimin e strukturës organizative të agjencisë

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 JANAR - Shoqata Sindikale e Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil (SPAAC) ka reaguar lidhur me mungesën e transparencës gjatë procesit të ndryshimit të rregullimit të brendshëm dhe strukturës organizative të agjencisë e iniciuar nga drejtori i përgjithshëm i AAC-së. Sipas SPAAC-it, ka mungesë të transparencës gjatë procesit të ndryshimit të rregullimit të brendshëm. "SPAAC që nga iniciimi i procesit me rastin e krijimit të Grupit Punues për hartimin e projektregullores për Organizimin e Brendshëm të AAC-së ka kërkuar vazhdimisht informata dhe transparencë në lidhje me procesin, përmes shkresave dhe takimit të mbajtur me drejtorin e përgjithshëm. Pavarësisht prej premtimeve të dhëna, drejtori i përgjithshëm i AAC-së ka shpërfillur këto

kërkesa. Nga shqetësimet e ngritura nga SPAAC ka qenë fillimisht fakti se në grupin punues për hartimin e projektregullores nuk është përfshirë asnjë anëtar i SPAAC dhe, për më tepër, nuk janë përfaqësuar as katër nga pesë departamentet profesionale-teknike të AAC-së. SPAAC-i ka kërkuar përfshirjen në Grupin Punues duke qenë se shumica e anëtarëve të saj kanë përvojën më të gjerë profesionale dhe menaxheriale, por kjo kërkesë nuk është përfillur", thuhet në reagim.

Po ashtu, thuhet se, ndonëse është obligim ligjor, projektregullorja nuk i është përcjell SPAAC-it për konsultim. "Përkundër premtimeve, projektregullorja nuk i është përcjell SPAAC-it për konsultim, ndonëse ky është obligim ligjor që buron nga Ligji për Organizimin Sindikal, që obligon menaxhmentin për të zhvilluar dhe promovuar dialogun



social. Edhe pse në emër të 'transparencës', sipas udhëzimeve të drejtorit të përgjithshëm, Grupi Punues ka kërkuar nga drejtorët e departamenteve në një afat shumë të kufizuar t'i dërgojnë inputet për rregulloren. Është imponuar në mënyrë eksplicite ideja e drejtorit të përgjithshëm për organizimin e brendshëm. Në asnjë fazë të procesit nuk ka pasur komunikim apo konfirmim për përfshirjen apo jo të këtyre inputeve. Projektregullorja nuk është vënë as në konsultim, edhe pse

konsultimi publik i akteve normative është obligim ligjor sipas Rregullores (QRK) 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, nenet 4 dhe 5.2.1.6", është thënë në reagimin e Shoqatës Sindikale e Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil (SPAAC). Kjo shoqatë kërkon që të respektohen standardet ndërkombëtare nga ICAO dhe EASA për nivelin e kërkuar të aftësive dhe kompetencës së stafit profesional. "Shqetësimi më serioz i ngritur nga SPAAC-i

është respektimi i standardeve ndërkombëtare nga ICAO dhe EASA për nivelin e kërkuar të aftësive dhe kompetencës të stafit profesional, si dhe për organizimin e brendshëm gjatë hartimit të Projektregullores në përputhje me kapacitetet teknike dhe nivelin e zhvillimit të industrisë së aviacionit në Kosovë. Këtë shqetësim ka ngritur edhe Autoriteti i Aviacionit Civil. Komisioni Evropian në shkresën drejtuar Ministrit të Infrastrukturës, më 14 tetor 2020, përmes së cilës ka kërkuar që standardet dhe rrethanat specifike në aviacion duhet të merren parasysh gjatë ndryshimit të rregullimit të brendshëm në AAC përpos kërkesave të reformës së administratës publike, sidomos për ruajtjen e kapaciteteve profesionale në të cilat ka investuar shumë shteti i Kosovës ashtu edhe Komisioni Evropian dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë", theksohet në reagimin e kësaj shoqate.

Mazreku dhe Ahmeti nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi



PRISHTINË, 20 JANAR (ER) - Ushtruesi i detyrës i drejtorit ekzekutiv të Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), Sami Mazreku, ka nënshkruar të mërkurën memorandum bashkëpunimi me kryeshefin

ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), Avni Ahmeti. Përmes këtij memorandum synohet lejimi i qasjes nga AKK-ja për kompanitë e sigurimeve për leximin dhe printimin e

informatave në Regjistrin e të Drejtës së Pronës së Paluajtshme (RDPP). "Nëpërmjet këtij sistemi për të cilin Agjencia Kadastrale e Kosovës i krijon qasje Byrosë Kosovare e Sigurimit,

kompanitë e sigurimeve përmes shfrytëzimit të uebshërbimeve do ta kenë mundësinë e regjistrimit të hipotekave në mënyrë elektronike duke mundësuar qasje më të mirë në shërbimet

publike, e cila ndikon drejtpërdrejt edhe në rritjen e efikasitetit dhe procesimin e procedurave të lëshimit të garancive nga kompanitë e sigurimeve", është thënë në njoftimin e BKS-së.

Nënshkruhet marrëveshje në mes të komunës së Malishevës dhe Fondacionit "Jahjaga"

MALISHEVË, 20 JANAR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka pritur të mërkurën zyrtaren e Fondacionit "Jahjaga", Doruntina Ukimerin, të cilën e ka njoftuar për mbështetjen institucionale që komuna i ka dhënë Zyrës Juridike për Shërbime Falas, ku qytetarët mund t'i parashirojnë kërkesat

e tyre.

Ai ka thënë se edhe akti i nënshkrimit të marrëveshjes me Fondacionin "Jahjaga" do t'ua lehtësojë shumë shërbimet juridike qytetarëve të kësaj komune.

Ndërsa zyrtarja nga Fondacioni "Jahjaga", Doruntina Ukimeri, ka theksuar se qëllimi i kësaj

marrëveshje bashkëpunimi është që, përveç se t'u ndihmohet qytetarëve me shërbime falas nga zyra juridike, njëherësh edhe përmes shumë aktiviteteve që do të zhvillohen në të ardhmen, është edhe ngritja e vetëdijesimit si dhe informimi i qytetarëve për t'i adresuar kërkesat e tyre.



Lladrovci takon kryesuesin e KKZ-së në Drenas lidhur me përgatitjet për zgjedhje



DRENAS, 20 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim zyrtarin e lartë komunal të zgjedhjeve, Burim Jonuzi, me të cilin kanë diskutuar lidhur me ecurinë e përgatitjeve teknike për realizimin e zgjedhjeve parlamentare.

Lladrovci në këtë takim ka theksuar se KKZ-ja do ta ketë mbështetjen e komunës për realizimin e zgjedhjeve në mënyrë transparente dhe pa probleme. Ndër të tjera, ai e njoftoi se të gjitha shkollat dhe qyteti është në monitorim të kamerave, për t'i evituar problemet eventuale dhe

raportimin e tyre në organet gjegjëse.

Ndërsa Burim Jonuzi e ka informuar kryetarin Lladrovci lidhur me përgatitjet që janë bërë deri më sot, duke shprehur përkushtimin maksimal që procesi i zgjedhjeve në Drenas të jetë i qetë dhe pa ndonjë problem.

Bahtiri nënshkroi vazhdimin e kontratave për bursa për 42 studentë

MITROVICË, 20 JANAR (ER) - Në sallën e Kuvendit Komunal, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka nënshkruar të mërkurën kontratat me 42 studentë që u janë vazhduar bursat për vitin akademik 2020/21. Me rastin e nënshkrimit të kontratave të pranishëm ishin kryetari Agim Bahtiri si dhe drejtoresha e Administratës, Valmire Sylejmani.

Kryetari Bahtiri i ka përgëzuar studentët e përzgjedhur, duke u uruar suksese në të ardhmen dhe përfundim të suksesshëm të studimeve me rezultate sa më të mira. Pas nënshkrimit të kontratave, studentët u shprehën të jenë mirënjohës për mbështetjen që komuna po ua ofron, si një motiv shtesë për t'i vazhduar studimet dhe një lehtësim financiar për familjet e tyre.



Gjilani ka aktualisht 170 raste aktive me Covid-19

GJILAN, 20 JANAR (ER) - Nën udhëheqjen e nënkryetarit Arbër Ismajli, Komiteti i Gjilanit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve lokale dhe regionale. Nënkryetari Arbër Ismajli ka njoftuar se aktualisht në Gjilan janë 170 raste aktive me virusin, ndërkaq ka bërë apel që të respektohen masat kundër përhapjes së Covid-19. Ai

njoftoi, po ashtu, se 120 mostra janë në pritje për rezultat, kurse ka shfaqur shpresën të mos ketë rritje të rasteve. Gjendja e përgjithshme e Gjilanit sa i përket përbaljes me pandeminë brenda dhjetë muajve është si vijon: nga 8 802 mostra, 3 305 kanë rezultuar pozitive, 3 032 janë shëruar, 103 kanë vdekur, 170 raste janë aktive, 28 persona të konfirmuar Covid-19 pozitivë janë të shtirë në spitale dhe po presin 120 mostra të testuara.



Bulliçi vizitoi shkollën në fshatin Llugë e cila u përfshi nga zjarri

PODUJEVË, 20 JANAR (ER) - Një pjesë e Shkollës Filllore e Mesme e Ulët "Ilir Konusheci" në fshatin Llugë të mërkurën në mëngjes është përfshirë nga zjarri i cili ka shkaktuar dëme në këtë objekt.

Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliçi, ka vizituar shkollën e fshatit Llugë, për t'u njoftuar nga afër me gjendjen e objektit dhe dëmet e shkaktuara si pasojë e zjarrit. Kryetari

Bulliçi tha se, bazuar në informacionet e para, zjarri në fillim ka përfshirë kulmin e objektit dhe, falë intervenimit të zjarrfikësve dhe policisë, është lokalizuar. "Fatmirësisht zjarri nuk ka shkaktuar

dëme në njerëz. Janë dëmtuar dy dhoma mësimi dhe tri banja", ka thënë Bulliçi, duke shtuar se komuna do të intervenojë në kohën sa më të shpejtë për sanimin e dëmeve të shkaktuara.



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (6)

Përrjashtohet nga shkolla vetëm pse ishte motra e Aziz Kelmendit




Lulzim SAHITI

Ditën e hënë, më 7 shtator 1987, Melihatja kishte shkuar në shkollë si zakonisht, mirëpo të nesërmen ndryshon gjithçka. Ishte ora e pestë, ajo e Historisë, kur nxënësit prisnin profesoreshën Bukurie Morina për të filluar orën e rregullt mësimore. Pak pa filluar kjo orë shkon në klasë kujdestari i klasës dhe e fton Melihatën, duke e porositur që ta marrë me vete çantën dhe bashkë me të lajmërohen te drejtori i shkollës. Duke zbritur shkallëve nga kati i tretë, kanë takuar profesoreshën Bukurie. Ajo i drejtohet kujdestarit të klasës: “Ku po e çon çikën, ku po e çon çikën...?” E brengosur tej mase, pa pasur mundësi të bënte diç, ishte ngjitur përpjetë shkallëve. Atje në klasë, para nxënësve, thuhej se mësimdhënësja Bukurie sillej vërdallë nëpër klasë duke thënë: “Jua morën shoqen, jua morën shoqen...!” Kur hynë në zyrë, aty gjendej drejtori i shkollës bashkë me anëtarët e Këshillit të Nxënësve, që përbëhej edhe nga mësimdhënësit. I pranishëm ishte edhe arsimtari i gjuhës angleze dhe dy policë. Me këtë rast, drejtori i jep Melihates vendimin e Lidhjes së Rinisë Socialiste që ishte përjashtuar nga kjo organizatë rinore dhe nga shkolla, ndërkaq policët i kishin thënë se duhet të shkojë me ta në SPB të Prizrenit sepse kanë urdhër ta marrin me vete. Nëse ke ndonjë shoqe të ngushtë, policët i sugjerojnë ta marrë me vete, mirëpo fjalë pas fjalë kishin vendosur të shkojë ajo vetëm. Me të dalë në oborr të shkollës, nën shoqërim të policisë, një shoqe e klasës (Shyqerije Kryeziu) e kishte parë nga dritarja, e cila nga kati i tretë filloi të çirrej nja dy-tri herë me sa zë që kishte: “Meli ku po shkon...!” Në Sekretariat kur kishte mbërritur, atë e merr në pyetje një inspektor i sigurimit shtetëror shqiptar, ku në tavolinën tjetër qëndronte ulur edhe një hetues serbë. Gjatë kohës sa ishte duke shërbyer Azizi në shërbimin ushtarak, në emër të familjes Melihatja kishte komunikuar me të përmes letrave. Siç dihet mirëfilli, shtëpia e familjes së

Azizit ishte kontrolluar nga policia më 3 dhe 5 shtator 1987 dhe gjithçka që kishin gjetur në emër të tij e kanë marrë me vete duke përfshirë librat, fletoret, letrat e tij që kishte komunikuar me familjen nga ushtria etj. Gjatë bisedës informative ata ishin të interesuar të dinë se me kënd ishte shoqëruar Azizi, domethënë cilët ishin shokët e tij, pastaj e kishin pyetur Melihatën se a mos kanë komunikuar me kode me të ndjerin e kështu me radhë. Në vitin 1987 ishte koha kur diskutohej për flamurin kombëtar shqiptar, ku asokohe kërkohesh që yllit të verdhë pesëcepësh që ishte mbi shqiponjën dykrenare t'i ndërrohet vendi e madhësia e tij. Për këtë, Azizi në atë kohë, gjatë komunikimit me letra, e kishte shprehur shqetësimin e tij, tregon Melihatja. Prandaj, inspektorët e sigurimit shtrorin pyetje të ndryshme.

“Ata më ofronin fletoret e Azizit (të gjitha fotokopje), për të cilat më thonin ‘shiqo çka ka shkruar Azizi’, tregon Melihatja. “Mbaj mend dy vjersha, njëra titullohej: ‘Vëllezërit Gërvalla në Gjermani’, por nuk më kujtohen rreshtat e saj. E di që inspektorët më thoshin: ‘A po e sheh çka ka shkruar?’ Vjersha tjetër mbante titullin ‘Vajza sylaroshë’, ku bëhej fjalë se u ndamë (më duket), thashë lamtumirë, eca dhe e ktheva kokën, ia pashë lotët në faqe...” Ata bënë përpjekje dhe dëshironin të dinë se a ka pasur Azizi ndonjë vajzë të dashur sylaroshë? “Unë vërtet nuk kam ditur lidhur me këtë çështje”, tregon Melihatja.

Përjashtimi i saj nga shkolla kishte bërë bujë. Mediat sllovene e kroate kishin reaguar duke potencuar se ngjarja është zhvilluar në Paraqin e në Kosovë po ndëshkohet një mitër vetëm pse është motra e Aziz Kelmendit. Lajmi kishte bërë jehonë të madhe tek opinioni publik dhe pas dy jave, drejtorja e shkollës detyrohet nga presioni publik që të ftojë Melihatën për vazhdimin e mësimin të rregullt. “Dy-tri javët e para vlonin gazetarët para shtëpisë tonë”, tregon Melihatja. “Atë ditë që rifillova mësimin një gazetar shqiptar më tha: Këta janë gazetarë sllovenë dhe po iu intereson a të kanë përjashtuar nga shkolla? Po u thashë, por sot më kanë kthyer përsëri. Të nesërmen, për të vërtetuar këtë gjë, të njëjtët gazetarë kishin shkuar në klasën e Melihates, të cilët fotografonin klasën dhe ditarin...”



Studenti i drejtësisë, Aziz Kelmendi (1967-1987)

Shërbimi ushtarak në Paraqin dhe shoqërimi i shqiptarëve gjatë kohës së lirë

Në Kazermën e Paraqinit shërbenin ushtarë të të gjitha nacionaliteteve të ish-Jugosllavisë, në mesin e të cilëve kishte edhe shqiptarë nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi. Ata ishin kryesisht rekrutë të ardhur nga kazermat e tjera, të cilët, pas përfundimit të trajnimit tremujor (që njihet si “Obuka”) në lëmenj të ndryshëm ushtarakë, janë transferuar në Paraqin. Më 14 shtator 1986, Afrim Mehmeti dhe Aziz Kelmendi kishin nisur trajnimin ushtarak për tanke në Postën Ushtarake në Leskocv. Mandej, në muajin dhjetor, të dytë së bashku i dërgojnë në “prekomandë”, një javë në Dellovac e pastaj i transferojnë në Kazermën e Paraqinit. Pas kryerjes së trajnimit tremujor për këmbësori, në janar të vitit 1987 nga Kazerma e Knjazhevcit ishte transferuar Pajazit Aliu në Paraqin. Ndërkaq, më 26 qershor 1987 nga Kazerma e Zajçarit e transferojnë edhe Rizah Xhaklin si vozitës dhe dhjetarin Rizo Alibashiq. Gjithashtu, po në muajin qershor nga Kazerma e Nishit kishte ardhur në Paraqin, Abdylxhemil Alimani, i cili atje, nga data 18 mars 1987, e kishte kryer trajnimin për shërbim teknik-ndërlidhës. Kështu ka vazhduar ardhja edhe e rekrutëve të tjerë në Paraqin. Gjatë gjithë shërbimit ushtarak, Afrim Mehmeti ka qenë gjithnjë së bashku me Azizin, kurse më pas ka vazhduar shoqërimi i tyre edhe me Rizah Xhaklin, Abdylxhemil Alimanin, Shefqet Paçarizin, Pajazit Aliun, Enver Behlulin dhe Islam Mahmutin, i cili ishte pjesëtar i komunitet rom, mirëpo gjithnjë shoqërohej



Melihate Kelmendi

me shqiptarë ngaqë nuk e njihje fare gjuhën serbokroate. Në momentin kritik ka pasur edhe disa shqiptarë të tjerë që nuk kanë qenë në kazermë, por ishin duke ruajtur depot ushtarake të municionit në vendin e quajtur “Karadjordjevo Brdo”, rreth 3 kilometra larg Garnizonit të Paraqinit. Në vendin e rojës kanë qenë: Isuf Ponik nga Prizreni, Sejfullah Selimoviq nga Shkupi dhe Feti Zuka nga Kamenica, ndërsa atë natë ushtari Nexhmedin Hajrizi nga Gumnasella e Lipjanit kishte qëlluar larg kazermës. Gjatë kësaj periudhe shqiptarët që shërbenin në Kazermën e Paraqinit gjatë kohës së lirë kishin realizuar nderja e takime të ndryshme spontane. Gjatë takimeve të tyre të përbashkëta ato shoqëroheshin kryesisht me diskutime të rëndomta për familje, por nuk mund t'i anashkalonin edhe bisedimet e shumta për situatën e atëhershme politike që mbretëronte në Kosovë, siç ishin: Ardhja e Sllobodan Millosheviqit në Fushë-Kosovë më 24 prill 1987, ku me fjalimin e tij nacionalizmi serb u legjitimua nga kreu më i lartë politik i Serbisë, pastaj fushata serbe kundër Fadil Hoxhës, organizimi i mitingjeve serbe, situata e tensionuar me provokime të llojllojshme në Kosovë, kinse shqiptarët po provokojnë serbët e shumë e shumë shkrime dhe

lajme të njohura të asaj kohe. Thjesht, fushatës së Serbisë kundër Kosovës dhe çdo gjëje që lidhej me shqiptarët nuk po i shihej fundi. Të gjitha këto lajme, shkrime dhe veprime të Jugosllavisë së atëhershme kishin krijuar një situatë të urrejtjes së vazhdueshme ndaj shqiptarëve. Andaj kjo gjë reflektohej edhe në mesin e shqiptarëve ku shërbenin në ushtrinë jugosllave, ku në shumë raste kanë qenë rëndë të ofenduar në aspektin kombëtar, që ndonjëherë eskalonte deri në përlëshje fizike. “Pra, si ushtarë shqiptarë shpeshherë mbledheshim dhe diskutonim këto gjëra, ku më i zëshmi ishte Aziz Kelmendi dhe e dëgjonim me vëmendje. Të gjitha këto diskutime në mënyrë spontane kanë ndodhur në fushën e sportit dhe në korridorët e pavijonit”, tregon Afrim Mehmeti. Të gjitha këto takime e nderja më vonë u përdorën nga hetuesit ushtarakë për montim të procesit të Paraqinit, si “takime për koordinim të veprimeve për vrasje me motive armiqësore kundër Jugosllavisë”. Zakonisht, këto takime ishin të rralla sepse shumë nga ushtarët ishin të nxënë me detyra të zakonshme ditore. Kjo karakteristikë apo natyrë e tubimit të ushtarëve shqiptarë në çaste të caktuar ka qenë e natyrshme kudo në Ushtrinë Jugosllave. (Vijon)

A do e tundë Nard Ndoka flamurin e opozitës?!



Bedri Islami

Tre muaj e disa ditë më shumë ndajnë zgjedhjet e përgjithshme politike në Shqipëri. 25 prilli, si duket do të jetë një ditë surprizë, sido që të ndodhë. Nëse opozita do të fitojë, kjo do të jetë shenja më domethënëse se, edhe një rast ekstrem, kur i ke humbur të gjitha nga fataliteti halucionant i shefit të opozitës dhe pushtetit i ke dhënë gjithçka, që nga parlamenti i sajuar ku mendjelehtësia në braktisjen e sallës dhe përzgjedhja tip kunetor e ka shndërruar në një turm amorfe, pushteti lokal, institucionet qendrore financiare, pra, edhe një një rast të tillë, mund të fitosh. Nëse do të konfirmohet edhe një herë e majta e Edi Ramës, ky do të ishte përjashtimi i parë nga rregulli i pa shkruar i dy mandateve, dhe krijohet precedenti i parë i tre të tillë, e për më tepër kur ke humbur shumë që nga fillimi i qeverisjes.

Mandati i tretë i Edi Ramës duket më i mundshmi i tanishëm, jo vetëm se qeverisja dhe ekipi i tij ia ka filluar punëve që heret, jo vetëm se ka pasur e ka në dorë resurse që nuk i ka askush tjetër, por edhe se përballë ka një opozitë që vetm e tillë nuk është.

Përballë Edi Ramës janë vënë të gjithë dhe, si duket shumë do të jenë të humbur. "Dibra" si shenjë e pushtetit mbi zgjedhjet do të duket një rastësi e padëmshme, karshi asaj që mund të ndodhë, për më tepër kur opozitën nuk e zgjon dot as një e rënë këmbane.

Jan të shumta ata që janë grumbulluar e presin të strehohen nën siglën e PD-së, si forca kryesore e opozitës, por "krahët" e saj nuk janë aq të gjërë sa t'i mbulojnë të gjithë dhe s streha e saj nuk është aq e gjërë sa t'i mbledhë të gjithë.

Partia Demokratike ndodhet në periudhën më shterpë të saj: pa ide, pa asnjë kauzë të lindur prej saj, pa mendim të ditës dhe të perspektivës, me një ripërsëritje monotone jashtë parlamentit, ku zëri, herë i ngjirur dhe herë si i fortë i Bashës, as nuk josh e as nuk tremb njeri; ku gjithçka dihet, deri edhe cili do të hedhë miell e kush ka marrë përsipër ujët,

me një shef faktik të lodhur dhe të kthyer në një paranajok naiv se po e ndjekin, duan ta dëbojnë nga rrjetet sociale, dhe mbi të gjitha, përmes një lëvizje politike tepër budallaqe, në rrezikun për t'u kthyer në ndokaparti.

Një forcë politike që bën një luftë mullijsh për Teatrin Kombëtar, duke sulmuar "oligarkun" Fusha dhe pastaj ia merr djalin për deputet, dhe për më tepër, e bën atë shenjë dalluese të lëvizjes së saj politike, në mos tjetër; që për tri ditë bën kauzë vendosjen e traut në Rrugën e Kombit dhe pastaj e ndërton atë me disa zyra komode, më e pakta kjo; që bën "agjëron" për dy vite me aleatët e saj për një vizion të ri dhe më pas e kthen të gjithën në sigurimin e vendeve të sigurta në listat për deputetë, që nuk e di saktësisht se cili nga aleatët e deritashëm nuk do e tradhtojë nesër, sapo Edi Rama t'u tundë postet, dhe që, pasi flak nga rradhët e saj një intelektual të njohur, nga një derë fisnike, Romeo Gurakuqin, dërgon në vendin e tij Nard Ndokën, për të qenë përfaqësues politik i qytetit të shenjtë verior, kjo do të thotë se as nuk kanë kuptuar e as nuk e kanë ndër mend të kuptojnë nga perceptimi politik i një brezi të ri, i cili, tashmë nuk kërkon shpëtimin nga myku që ka zënë vend në "tempujt" e partive politike.

Është një moment kur brenda saj janë ravijëzuar tri linja kryesore: ajo e skifterëve, të prirë nga Berisha, që e ndjen se posti i deritashëm po rrokulliset; ai i "paqtuesve", që presin të përcaktohen si kandidatë për deputetë dhe mendojnë se si do e kalojnë këtë periudhë vegjetimi, gjithnjë me shpresën se kur do të mund të vijnë në pushtet nuk do të harrohet përkushtimi i tyre, dhe, të tretët, një grup i krijuar rishtas përmbri shefit të partisë, si një garnizon politik, i cili ka mbështjellë rreth vetes idenë e lidershipit dhe, të gëzuar se u erdhi koha, krkojnë me çdo kusht të dalin në paraskenë, edhe para se të ngrihet perdja.

Në grupin e parë, të skifterëve, megjithëse shumë janë pa pupla, figurat më domethënëse, edhe e grishjes për luftë e dhunë, nganjëherë edhe e shkallës së lartë "të inteligjencës" janë disa sosh, ku janë bashkuar konglomerati politik që nga Nard Ndoka, Duka, Shehu, Marku, Dule që pret të bëjë lëvizjen e tij, pasi të ketë ndërhyrë dikush ifuqishëm nga ortodoksia, Idrizi që lufton

me kartën e nacionalizmit, por që çështjen çame po e dërgon drejt humnerës. Të rradhitur pas tyre një grup tjetër, gjysëm skifterësh, por me çjerrje të larta, si Paloka, Salianji që pret që përkushtimi i tij të shpërblehet dhe udhëheqja e partisë të mos ketë harruar kontributin e tij në çështjen Babale; Spahiu, që dikush nga mosnjohja e vendosi në familjet e prekura politikisht dhe ish të burgosura nga regjimi i kohës së shkuar, dhe, në fund, "mrekullia" e parlamentit të shkuar, që nuk e duan as të vetët, i biri i Balliut, njeri që kërcënoi se herën tjetër do të ngrinte në këmbë gjithë Shqipërinë dhe se, me dhunë e vetëm me dhunë, do të përmbyste qeverinë Rama. E që tani, për hir të "mëmëdheut", nëse nuk e vendosin në listën e së djathtës, shkon pak majtas, tek lësëistët.

Mbi të gjithë këto qëndron Berisha dora e hekurt, i cili, që nga dita e parë e parlamentit të pasqershorit 2017, as më pak e as më shumë, kërkoi djegjen e mandateve, largimin nga parlamenti, hedhjen në Lanë të shefit të qeverisë, zënien në çark të tij dhe, në fund, pa asnjë droje, pasi e di se shteti ende nuk është ngritur, deklaroi haptas se, në pasditen e 21 janarit, pasi ishin vrarë katër vetë, ai kishte kërkuar 5 snajperë, katër në katër qoshet e godinës qeveritare dhe një për atë, pikërisht shefin e qeverisë, që kishte vendosur të vriste shefin e opozitës dhe, për më tepër, të mbante fjalimin më mallëngjyes që ishte mbajtur ndonjëherë.

Ky grup, i skifterëve, duke pasur pas vetes Berishën, i cili nuk e fsheh se ai është frymëzuesi i kësak rilëvizje politike agresive brenda llojit të tij, dalngdalë po bëhet vendosës dhe kryesor në jetën e partisë së tyre.

Lëvizja radikale në PD nuk është as e re dhe as e papritur. Por në pragun e 25 prillit ajo mund të bëhet ekstremisht radikale dhe ekstremisht dhunuese. Qeverisja Rama ka sjellë mjaft zhgënjime, disa nga të cilat mund të jenë fatale pr vetë vendin, dhe "shtrimi" i rrugës që po i bën ai rritjes së radikalizmit opozitar, përmes mospërfilljes, tonit përbuzës dhe lojës së rëndë, mund të sjellin avragime të ndryshme, ku fajtor nuk do të jet ai, por ata që do të nxisin turmat. Ky mentalitet që po forcohet tek opozita, që duke hequr mendimin, bën vend për një ndokaparti, do e dëmtojë atë dhe do të forcojë autokracinë në qeverisjen e vendit.

Ndryshimi i tashëm, megjithëse ende jo i dukur sa duhet, është se ajo ka nxjerrë në krye të saj njerëz të dhunshëm, të paditur, në mos injorantë politikë, të cilët dhunën e përceptojnë si rrugë të vetme për marrjen e pushtetit dhe që, nga mungesa e njohurive, gjuhës së rëndomtë dhe mungesës së ideve, e gjejnë veten pikërisht tek dhuna.

Gjuha e përdorur prej tyre, që nga Berisha, Meta, Bardhi një ardhje e habitshme në lidershipin kryesor të opozitës, dhe deri tek Balliu i vockël, është e njëjtë me atë që kanë përdorur ekstremistët në të gjitha kohrat e vendet, kohët e fundit edhe në sulmin ndaj Kapitolit...por e artikuluar në gjuhën shqipe, me një kontenacion serb. Shumë vite më parë, Shesheli, radikali i njohur serb, deklaronte se serbët e vërtetë do të shkallmojnë institucionet e Zoran Gjingjiq, e për këtë dikush do e japë edhe jetën e tij, ndërsa tani, një radikal i vockël shqiptar shqiptar, gjithësesi miniaturë e një mendësie radikale, Paloka deklaronte haptas se "protestuesit ishin gati për gjithçka. Sot mund të kishte edhe të vrarë". Flamurin e nacionalizimit serb që kërkonte Shesheli tani e kërkon Berisha, i cili, ende pa vajtur njerëzit në shtëpitë e tyre pasditen e 26 majit, do të deklaronte se "Nëse Basha nuk do të tërhiqte protestuesit, do të vendosnim flamurin e fitores si me 14 shtator 1998".

Mendësia e dhunës, si rrugë e vetme politike për të ardhur në pushtet, e shfaqur që me 2 prill të vitit 1991, si një gjak i keq, është transmetuar nga një grupim politik i një brezi, tek një brez tjetër. Por, ndërsa dikur, një herë e një kohë, lëvizja radikale kundër komunizmit ishte e justifikuar dhe e prirë nga njerëz që njiheshin si intelektualë të klasit të parë, sot, nuk është për të qeshur kur vjen nga birbëz politik që, në delirin e fjalës, pa asnjë lloj përgjegjësie deklarojnë se "Vërti gishtin kokës zoti Rama. Herën tjetër nuk do i tërheq shqiptarët. Rama nuk ikën në rrugë ligjore, atë mund ta rrëzojmë vetëm përmes dhunës". (Balliu junior) Përse ndodh e gjithë kjo? Përse zëra të mënçur brenda grupit parlamentar të PD-së kanë heshtur dhe, megjithëse është pritur ndryshe, nuk kanë më asnjë rol dhe po bëjnë figurantin politik të Ndokës, Palokës, Spahiu, e disa kokrrave që mendojnë se do tërrinë gjatë deputet vetëm përmes dhunës? Ose e zgjatimit në kurrizin e një

force të madhe politike, ashtu sirriten vemjet në trupin e lodhur të një peme! Përse hapësira e mendimit është mbyllur për disa dhe është hapur vulgu i fjalës tek të tjerët? Berisha, epiqendra ku mblidhet e keqja, jo vetëm se gjithnjë ka adhuruar dhunën dhe është rrënuar nga mendimi, megjithëse një njeri i lexuar dhe me kujtesë fenomenale, por edhe e ka praktikuar atë. Ai ishte i pari që e kuptoi se forca politike ku u vendos në krye përmes dhunës, nuk mund të qëndronte gjatë si e tillë, nëse do të depërtonte mendimi dhe nëse fjala do të ishte e para.

E ka një shkak madhor. Më mirë se të gjithë ata e dinë se Vettingu ka filluar me drejtësinë, por jo Opozita ka figura të mënçura dhe të denja për të qenë pjesë e ndryshimit, jo vetëm politik, por edhe të konceptimit të lirisë, si një domosdoshmëri historike.

Të heshtur ose jo, të mënjanuar ose jo, të sulmuar nga të vetët, por edhe nga media të pakta, këto njerëz mund të përbëjnë thelbin e një opozite që largohet nga mediokriteti, nga një turmë që i janë veshur nga pas politikës dhe po shkyejnë pasuritë e saj; koha për të bërë një lëvizje radikale, brenda vetes, dhe afishimin e atyre që kanë vlera të duhura, të besueshme dhe reale ka adhur dhe po ikën. Emërimi i drejtuesve të rinj politikë në disa qarqe nuk ka sjellur ndryshimin, jo se ata janë në përgjithësi emra të vjetër, por nuk kanë asnjë vizion ndryshe nga e shkuara. Dhe e kanë humbur besimin. Nëse në Vlorë ta zëmë, njerëzit e besojnë Bujar Leskajn, edhe ai nga figurat e herëshme të opozitës, nuk vjen nga që ai po krijon lidhjet e tij, por nga fakti që në kaq vite nuk i ka humbur këto lidhje. Ka qenë i pranishëm, si i thonë, në të mirë e në të keq, dhe këtë nuk mund ta bëjnë ata që venë një herë në hënë, sa për të të qenë të sigurtë se do të jenë deputetë.

Dhe këtu rinis pastaj rrugëtimi i "të fortëve", që nuk po reshin se qenuri pjesë e forcave politike.

Të pakënaqur me pavendosmërinë e Bashës, si një lëvizje hamletiane e politikës ngurruese dhe dembele, ata duan të hapin një rrugë, për t'i dhënë zemër vetes dhe, përmes vetes, edhe metingashëve të tyre. Askush nuk e di se si do të vazhdojë kjo lëvizje. Atyre u përshtatet perifrazimi i një poezie të njohur të Kadarese, që mund të shqiptohet, "Nga dhuna vijmë, drejt dhunës shkojmë".

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



9 789951 780377



DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €




9 789951 780100

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Peja triumfon në derbi ndaj Rahovecit

PEJË, 20 JANAR - Peja ka triumfuar në derbin e xhiros së 16-të në Superligën e Kosovës, duke mundur Rahovecin me rezultat 90:85 (20:18, 19:16, 24:24, 27:27). Ndeshja në 'Karagaçi' ishte mjaft interesante dhe dramatike, por pejanët ishin më të vëmendshëm në fund dhe shënuan fitore. Çereku i parë ishte mjaft i barabartë dhe përfundon 20:18 në të mirë të vendasve. Lojë e ngjashme u zhvillua edhe në periudhën e dytë, që përfundoi 19:16, derisa skuadrat shkuan në pushim me rezultat 39:34. Peja e thelloi edhe më shumë epërsinë në periudhën e tretë, 55:41, por Vreshtarët hyjnë në një seri të suksesshme, duke afruar shifrat në 60:58, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 63:58. Mysafirët afruan rezultatin në 10 minutat e fundit në 66:65, e më pas edhe në 82:80, një minutë para fundit, megjithatë, pejanët ishin më të përqendruar në fund dhe triumfuan 90:85. Te Peja u

dalluan Brandon Ĕalters me 24 pikë e 15 kërcime, Marko Peroviq me 25 pikë e gjashtë kërcime dhe Dardan Berisha me 22 pikë, pesë kërcime e shtatë asistime, kurse te Rahoveci u dalluan Marvin Jones me 35 pikë e katër kërcime, Isaiah Traylor me 25 pikë dhe pesë asistime dhe Alban Veseli me 16 pikë e 10 kërcime. Peja ka 11 fitore dhe pesë humbje, kurse Rahoveci 12 fitore dhe katër humbje. Ndërsa Ponte Prizreni ka shënuar fitore ndaj Vëllaznimit në Gjakovë me rezultat 92:112 (23:36, 30:21, 25:35, 14:20), në kuadër të javës së 16-të të Superligës së Kosovës në basketboll. Ndeshjen më mirë e nisi Ponte Prizreni, që e fitoi çerekun e parë 23:36. Por, Vëllaznimi u këndell në periudhën, duke e fituar 30:21, derisa skuadrat shkuan në pushim me shifrat 53:57. Në periudhën e tretë, vendasit afruan rezultatin në 66:67, por më prizrenasit u shkëputën në rezultat, duke e fituar këtë pjesë



25:35, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 78:92. Në 10 minutat e fundit, Ponte Prizreni ruajti epërsinë dhe triumfoi në fund me rezultat 92:112. Vëllaznimit nuk i

ndihmuan as 35 pikët, 11 kërcimet dhe pesë asistimet nga Christopher Hortman, kurse te Ponte Prizreni u dalluan Divine Myles me 39 pikë, Josh Martin me 12 pikë e 19 kërcime, Urim

Zenelaj me 10 pikë e 12 kërcime, Arti Hajdari me 21 pikë dhe Xavier Cannefax me 19 pikë. Vëllaznimi ka katër fitore dhe 12 humbje, kurse Ponte Prizreni 11 fitore dhe pesë humbje.

Dumoshi: MKRS-ja vazhdimisht i përkrah sportistët e rinj



PRISHTINË, 20 JANAR - Në kuadër të mbështetjes së të rinjve që merren me sport, ministrja MKRS-së, Viora Dumoshi ka takuar të mërkurën sportistën e re Elda Zeqiri, kampione e tetëfishtë e Kosovës, në kategori të grupmoshave të ndryshme në Taekwondo. Taekwondistja Zeqiri e njoftoi ministren Dumoshi për pjesëmarrjen në garat e shumta dhe për sukseset që ka korrur brenda dhe jashtë vendit, duke u shpallur kampione në shumë ngjarje sportive, ku mund të veçohen titujt e njëpasnjëshëm

në kampionatet e Kosovës në Taekwondo nga viti 2012 deri më 2020 si dhe një titull në Gjermani në garën e Bavaria Open. Zeqiri pret që institucionet dhe organizatat sportive t'i përkrahin të rinjtë dhe të rejtat që merren me sport sepse kanë nevojë të shumta, duke i pasur parasysh edhe pasojat që ka sjellë pandemia. Ndërkaq ministrja Dumoshi e përgëzoi sportistën e re për sukseset dhe fitoret e deritashme që ka arritur. Ajo ka thënë se MKRS-ja vazhdimisht i

ka përkrahur të rinjtë që merren me sport, por edhe në fusha të tjera. "Ne si ministri, përpos që i përkrahim organizatat sportive, në mënyrë të drejtpërdrejtë i përkrahim edhe sportistët e rinj nëpërmjet bursave dhe formave të tjera, në bazë të kapaciteteve dhe prioriteteve programore që kemi", u shpreh ministrja. Po ashtu, ministrja bëri me dije se është e interesit institucional dhe atij shtetëror që të kemi përfaqësim sa më dinjitoz në garat sportive duke treguar për qëllimet e avancimit cilësor dhe masivizimit në sport.

Drita në Antalia vazhdon fazën përgatitore

ANTALIA, 20 JANAR (ER) - Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani, të mërkurën ka arritur në Turqi për ta vazhduar fazën përgatitore. Drita ka njoftuar se në fazën e dytë përgatitore në Antalia do t'i zhvillojë katër ndeshje kontrolluese, përfshirë edhe ndeshjen e Superkupës ndaj Prishtinës e cila zhvillohet më 23 janar. "Në orët e hershme të mëngjesit klubi ynë ka udhëtuar për në Antalia të Turqisë për të vazhduar përgatitjet për sezonin pranveror. Nga gjashtë

janari klubi ka filluar fazën e parë të përgatitjeve dhe tanimë dihet që për fazën e dytë ekipi ka arritur në Antalia të Turqisë ku do t'i bëjë përgatitjet e fundit para fillimit të sezonit pranveror. Ekipi është vendosur në IC Green Hotel në Lara të Antalisë. Të gjithë lojtarët janë në gjendje të mirë fizike për këtë fazë", thuhet në njoftimin e skuadrës së Dritës. "Gjatë kësaj faze klubi ka paraparë që t'i zhvillojë katër ndeshje kontrolluese duke llogaritur edhe ndeshjen e Superkupës me

ekipin e Prishtinës, e cila është edhe ndeshja e parë zyrtare ku dy ekipe të Kosovës zhvillojnë një finale jashtë shtetit. Finalja e Superkupës është paraparë të zhvillohet më 23 janar dhe do të jetë ndeshja e parë për ekipin tonë në kuadër të ndeshjeve tona kontrolluese që ekipi do t'i zhvillojë në Antalia", thuhet në njoftimin në fjalë. Skuadra nga Gjilani ka njoftuar se për kundërshtarët dhe datat e ndeshjeve të tjera kontrolluese do të njoftohet opinioni gjatë ditëve të ardhshme.



Të shtunën grumbullohet Kosova U16

PRISHTINË, 20 JANAR - Të shtunën në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë do të mbahet grumbullimi i parë i Kosovës U16 në konkurrencën e meshkujve. Përzgjedhësi i Kosovës U16,

Dritëro Sefaja, ka përzgjedhur 40 lojtarë për këtë grumbullim, që do të ndahen në dy grupe, me nga 20 lojtarë. Nga ora 12:00 deri në ora 13:30 do të grumbullohen 20 lojtarët nga grupi i parë,

kurse nga ora 13:30 deri në ora 15:00 grupi i dytë. Të gjithë basketbollistët duhet të jenë të pranishëm në fushë 30 minuta para fillimit të stërvitjes. Kosova është organizatore e Evropianit të

Divizionit C për meshkuj U16 që do të mbahet gjatë kësaj vere në Prishtinë. Kosova U16 (M) do të jetë në Grupin B me Shqipërinë, Armeninë, San Marinon, Gjibraltarin dhe Maltën.



KOK-u i përzgjedhi 10 bursistët e rinj

PRISHTINË, 20 JANAR - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik i Kosovës në mbledhjen e 56-të të mbajtur në "Hotel Sirius", të parën për këtë vit, ka shqyrtuar pika të ndryshme të rendit të ditës. BE bëri përzgjedhjen e 10 bursistëve "Shpresa Olimpik 2021", të cilët do të marrin bursa në vlerë 150 euro në muaj nga Ministria për Kulturë, Rini e Sport, bazuar në Rregulloren Nr. 03/2013 për ndarjen e Bursave për Shpresat Olimpik dhe Paraolimpik. Në listë ndodhen nga dy sportistë të xhudos, karatesë, boksit dhe atletikës, ndërsa tenisi dhe skitaria kanë nga një. Në përzgjedhjen prej 28 aplikimeve të 13 federatave, janë marrë parasysh rezultatet e arritura në vitin 2020, ndërsa moshë e përcaktuar ka qenë 15-21 vjeç. Në ditët e ardhshme



BE i KOK-t, pritet t'i zgjedhë edhe bursistët "Shpresa Olimpik 2021", të cilët do të marrin paga nga Komiteti Olimpik i Kosovës, por që nuk ndodhen në këtë listë. Gjatë vitit 2020 bursa nga KOK-u morën 10 sportistë të federatave të notit, xhudos, atletikës, karatesë, boksit, shigjetarisë, taekvondosë, tenisit dhe mundjes.

Lista bursistëve

Erza Muminoviq (xhudo) Dardan Cena (xhudo), Betim Maliqi (karate), Albulena Gërvalla (karate), Alnera Brahimi (boks), Remzo Mustafiq (boks), Muhamet Ramadani (atletikë), Alaudin Suma (atletikë), Vesa Gjinaj (tenis), Drin Kokaj (skitari).

Bekaj: Ndaj Partizanit luajmë për fitore, mbrojtja jonë është më e mirë se sulmi i tij

TIRANË, 20 JANAR - Sot (e enjte) në "Elbasan Arena", duke nisur nga ora 18:00, luhet derbi në mes të Tiranës dhe Partizanit. Para kësaj sfide në konferencë për shtyp në kampin bardheblu doli portieri i Tiranës, Visar Bekaj. "Dardani" ka besimin se nëse Tirana triumfon dhe merr kthesën për te titulli kampion. "Çdo lojtar para derbit motivohet vetë. Morali rritet vetë dhe besoj atmosfera është shumë e mirë dhe në maksimum. Ta japim maksimumin në këtë ndeshje. Të dalim me fitore. Sulmi më i mirë? Nuk di të them. Besoj se ne nuk kemi ardhur në nivelin tonë dhe nuk kemi qenë i gjithë ekipi. Me kësmet e fitojmë derbin me Partizanin dhe do të jetë pika e kthesës. Partizani ka shumë lojtarë cilësorë, por derbi është gjë tjetër. S'besoj se ndihen njësoj si në ndeshje të tjera në derbi. Ne e kemi mbrojtjen më të mirë se sulmi i tyre. Ndihej keq për mospraninë e tifozëve, por



shpresoj të kthehen sa më shpejt dhe ndiej derbin ashtu siç i ka hije", ka thënë Bekaj. "Jam i kënaqur me mbrojtjen, por në sulm nuk kemi qenë shumë mirë, por besoj se me afrimet e reja do të shënojmë më shumë gola. Do të ishte më mirë të pësonim dy gola në një ndeshje dhe të shënonim tre sesa kështu 0-0. Gjithmonë provoj maksimumin

dhe them se paraqitem mirë. Hoxha është portier shumë i mirë dhe cilësor. Ai vetëm me përvojën që ka nuk e ka problem të luajë në Kategorinë Superiore. Mund të vjedh diçka te qetësia e tij. Idhull nuk kam askënd, por më pëlqen stili i portierëve gjermanë Manuel Neuer dhe Ter Stegen", ka shtuar Bekaj.

Milani në bisedime me Firpon

AC Milani është duke biseduar me Barcelonën për mbrojtësin Junior Firpo dhe shpreson të arrijë marrëveshje për huazimin me mundësi blerje. Sipas

"Calciomercato", ideja për përforcim është bërë reale dhe tani nuk shihet si pamundur kalimi i Firpos në "San Siro". Milani është në bisedime me Sufiel Abdelkader, babai i

Brahim Diazit, njëkohësisht agjenti i Firpos dhe duke marrë parasysh lidhjen e mirë, marrëveshja mund të arrihet lehtë. Gjiganti italian synon vetëm ta paguajë huazimin

me mundësi blerje, kurse Barcelona kërkon plot 20 milionë euro. Por, "Rossonerët" janë duke provuar përmes negociatave që këtë çmim ta zbresin në 15 milionë euro.

SHKURT

'Shqiponjat e Zeza' kërkojnë rikthimin e Dajakut

Drenica është një prej klubeve që ka bërë më se shumti transferime në këtë afat kalimtar, por tifozët e kësaj skuadre, "Shqiponjat e Zeza", kërkojnë edhe rikthimin e mesfushorit Taulant Dajaku. Këta tifozë e kanë publikuar një foto të Dajakut së bashku me kapitenin legjendar Sami Geci, duke treguar kështu që mesfushori është dëshira e tyre e fundit për merkaton. Taulant Dajaku ditë më parë njoftoi se është larguar edhe zyrtarisht nga skuadra e Ferizajt dhe tash është një futbollist i lirë.

Manaj kërkohe nga Crotone dhe Cremonese

Rei Manaj duket shumë pranë rikthimit në Itali. Për sulmuesin lushnjar, i cili është pjesë e Barcelonës B në ligën e tretë në Spanjë, së fundmi kanë shprehur interesim dy klube italiane. Bëhet fjalë për Crotonen që militon në Serinë A dhe Pescara që bën pjesë në Serinë B. Lajmi bëhet publik nga eksperti i merkatos Gianluca di Marzio. Pritet që në ditët në vijim të ketë zhvillime të reja për sa i përket të ardhmes së Manajt. Kujtojmë që shqiptari në të kaluarën ka qenë pjesë e Cremonesës, Interit, Pescarës dhe Pisës në Itali. Një rikthim në Serinë A do të ishte ideal për 23-vjeçarin i cili kërkon t'i shpalsë aftësitë e tij.

UEFA publikon formacionin e vitit

UEFA ka publikuar formacionin më të mirë të vitit të zgjedhur nga fansat. Në këtë formacion janë plot katër yje të Bayern Munichut, skuadër që ia doli ta fitojë tripletën. Në këtë formacion nuk mungojnë as dy yjet më të mëdhenj, Lionel Messi (Barcelona) dhe Cristiano Ronaldo (Juventus). Formacioni i vitit i UEFA-s i zgjedhur nga tifozët: Neuer; Kimmich, Ramos, Van Dijk, Davies; Alcantara, De Bruyne; Ronaldo, Messi, Neymar; Lewandowski.

Koeman: PSG kërkon Messin? Edhe mua më pëlqejnë Neymari dhe Mbappe

Trajneri i Barcelonës, Ronald Koeman, ka folur për interesimin e PSG-së për Lionel Messin. Holandezi ka thënë se edhe ai është i interesuar për dy yjet e skuadrës franceze, Neymar dhe Mbappe. "Nëse do të më pyesni nëse kam interes për Neymarin dhe Mbappe do të përgjigjesha po. Nuk e di se çfarë do të ndodhë në të ardhmen dhe nuk mund të jap mendim", ka thënë Koeman.

Cuadrado kalon Covidin

Futbollisti Juan Cuadrado është shëruar nga koronavirusi. Lajmin e ka konfirmuar edhe skuadra e Juventusit në faqen zyrtare duke bërë me dije se futbollisti do të jetë në dispozicion të trajnerit Andrea Pirlo. Cuadrado ka rezultuar negativ në dy testet e fundit dhe i ka dhënë fund vetizolimit për t'iu bashkuar tashmë pjesës tjetër të ekipit. Kolumbiani i ka munguar Juventusit në tri ndeshjet e fundit kampionale për shkak të koronavirusit derisa ende mbeten të infektuar Alex Sandro e Matthijs De Ligt.



TrafikuUrban

K O N K U R S

Pozita e punës: Mirëmbajtës i Objektivit (1 pozitë)

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit me mundësi vazhdimi

Orari i punës: I plotë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kujdeset për mirëmbajtje të objektit, instalimeve elektrike, ujësjellësit, dhe kanalizimit, mirëmbajtje të dyerve, dritareve, inventarit të zyrave dhe pjesët e tjera të objektit.
- Kujdeset për sistemin e ngrohjes dhe ventilimit, kujdeset edhe për hapësirën e gjelbëruar.
- Sipas nevojave të ndërmarrjes angazhohet edhe punët e natyrës së njëjtë me kërkesë të Udhëheqësit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse.
- Ndihmon në renovimin dhe dekorimin e objekteve brenda dhe jashtë, si dhe i përgjigjet në mënyrë efektive kërkesave emergjente të mirëmbajtjes.
- Bën vlerësimin për furnizim me pjesë dhe t'i porosisë ato në bazë të autorizimit;
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse.

Kriteret e kërkues:

1. Diploma e shkollës së mesme, drejtimi elektrikë ose elektroteknik
2. Përvojë pune së paku 3 vite në elektrikë.

Dokumentacioni i kërkuar:

3. Dëshmi mbi shkollimin,
4. Dëshmi mbi përvojën e punës,
5. Kopje të letërnjoftimit.

-Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Aplikacioni për punësim mund të merret në zyrat e Trafikut Urban apo përmes web-faqes së TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:


Kandidati/ja, duhet t'i dorëzojë këto dokumente në formë fizike në Zyren e Protokolit në Administratën e TU-në.

Konkursi është i hapur nga data 21.01.2021 dhe përfundon më datë 04.02.2021 në ora 16:00.

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë - Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 (0) 45 10 11 23



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Durim Cejku shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Milazim Berisha shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt 11 Marsi " Prizren.

► Memet Texha shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Nefit Jusufi " Skorobisht.

► Mihrije Fejza nga Drenoci i Klinës, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

